0

# Republika e Kosovës

*Komuna e Rahovecit*

**Kabineti i Kryetarit**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 48 Nr. i faq/Br.str/No.pg 99
Data/Datum/Date 16/1/23
RAHOVEC / ORAHOVAC

**LISTA E VENDIMEVE NGA KRYETARI I KOMUNËS SË RAHOVECIT, Z. SMAJL LATIFI: 3- 13 JANAR 2023**

| Nr | Emri i vendimit | Nr. Protokollit |
|---|---|---|
| 1. | Vendim për formimin e Komisionit të Rekrutimit për zhvillimin e procedures së pranimit në punë për pozitën Zyrtar për Lektorim | NRP-02-01-2023 |
| 2. | Vendim për dhënien e pushimit të lehonisë | NRP-02-08-2023 |
| 3. | Vendim për kompensimin e punës shtesë jashtë orarit të rregullt të punës për muajin dhjetor 2022 | NRP-02-17-2023 |
| 4. | Vendim për kompensimin e punës shtesë jashtë orarit të rregullt të punës për muajin dhjetor 2022 | NRP-02-18-2023 |
| 5. | Vendim për caktimin e Këshillit Organizues "Flaka e Janarit" | NRP-02-33-2023 |
| 6. | Vendim për shfuqizimin e vemdimit Nr.02/1397/22 I dates 5.1.2022 | NRP-02-35-2023 |
| 7. | Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e dëmeve | NRP-02-41-2023 |
| 8. | Vendim për caktimin e Këshillit Organizues | NRP-02-45-2023 |
| 9. | Vendim 16 janari 2023, shpallet ditë zie në komunën e Rahovecit | NRP-02-46-2023 |

Rahovec, janar 2023

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KRYETARI I KOMUNËS / PREDSEDNIK OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR
RAHOVEC ORAHOVAC

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

Nr./Br./No 1 Nr. i faq/Br.str/No.pg 95
Data/Datum/Date 11/1/23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008), në nenin 34 të Ligjit Nr. 06L-114 për Zyrtarët Publik, nenit 17 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosoves, si dhe nenit 92 të Statutit të komunës, Kryetari i komunës së Rahovecit merr këtë:

# V E N D I M

I. Me këtë vendim formohet Komisioni i Rekrutimit për të zhvilluar procedurën e pranimit në punë, të një specialisti i Administrimit të Përgjithshëm sipas konkursit RN00010472 -Zyrtar për Lektorim pranë Zyrës së kryetarit të komunës, në këtë përbërje:

1. Agron Thaqi, kryesues
1.1.Astrit Mullabazi, zëvendësues
2. Mirsad Shala, anëtar
2.1.Jeton Krasniqi,zëvendësues
3.Isak Hoti, anëtar
3.1.Flutura Beqiri ,zëvendësues
4.Skender Hamza ,anëtar
4.1.Habibe Haxhimustafa, zëvendësuese
5.Skender Kokollari, anëtar( ekspert)

II. Detyrat e komisionit janë të përcaktuara me Ligjin Nr. 06L-114 për Zyrtarët Publik dhe Rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosoves .

III. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset komisioni.

IV. Me vendim të njoftohet komisioni, Udhëheqësi i Personelit si dhe arkiva.

V. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**K R Y E T A R I**

Smajl Latifi

Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit/ Opština Orahovac/Municipality of Rahovec

Kryetari i komunës/Presednik Opstine/Municipal Mayor

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 08 Nr. i faq/Br.str/No.pg 95
Data/Datum/Date 5 / 1 / 23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës nr.03/L-040, nenit 49 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, Kërkesës së punëtores të miratuar nga eprori i drejtpërdrejt, si dhe nenit 92 të Statutit të komunës, Kryetari i komunës merr këtë:

## VENDIM
## Për dhënien e pushimit të lehonisë

1. **Znj. Granita Behra** nga Krusha e Madhe , e cila është në marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar dhe e sistemuar në punët dhe detyrat e punës: Zyrtare për Bibloteka 4 pranë Drejtorisë për Kulturë ,Rini dhe Sport, i aprovohet pushimi i lehonisë në kohëzgjatje prej 12 muajve sipas dispozitave të përcaktuara me Ligjin e Punës Nr. 03/L-212.
2. E lartpërmendura sipas Ligjit të Punës, 6 (gjashtë) muajt e parë të pushimit të lehonisë do të paguhet nga punëdhënësi me kompensim 70% të pagës bazë nga data dt.29.12.2022 deri 29.06.2023. Ndërsa, 3 (tre) muajt në vijim, pushimi i lehonisë paguhet nga Qeveria e Kosovës me kompensim 50% të pagës mesatare në Kosovë, nga data 30.06.2023 deri 30.09.2023. Ndërsa, 3 muajt e tjerë do të jenë pa pagesë.
3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

## A r s y e t i m

Punonjësja **Granita Behra** nga Krusha e Madhe, e cila është në marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar dhe e sistemuar në punët dhe detyrat e punës: Zyrtare për Bibloteka 4 pranë Drejtorisë për Kulturë,Rini dhe Sport, e ka njoftuar drejtorin e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, se nga data 29.12.2022 do të shkojë në pushim të lehonisë, sipas fletëlëshimit me Nr.14894 të spitalit Regjional të Prizrenit "Prim.Dr.Daut Mustafa"
Duke pasur parasysh se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore që punëtorja ta realizoj pushimin e lehonisë, data e shkuarjes në pushim të lehonisë konfirmohet sipas fletëlëshimit të spitalit .
Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshilla Juridike:** Nëpunësia ka të drejtë ankese në afatin prej 30 ditësh në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës, nga dita e marrjes së këtij vendimi.

***Vendimi u dërgohet:***

- *znj. Granita Behra*
- ***Drejtorisë për Kulturë,Rini dhe Sport***
- ***Drejtorisë për Buxhet dhe Financa***
- ***Dosja e punëtores***
- **Njësia e personelit**

**Smajl Latifi**

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr/Br/No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr/Br/No 17 Nr i faq/Br.str/No.pg 96
Data/Datum/Date 10/1/23
RAHOVEC/ORAHOVAC

Në mbështetje të dispozitave të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 21 paragrafi 3 pika 3.1 i të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civil Nr. 03/L-147 i datës 13.05.2010 dhe nenit 11 paragrafi 6 pika 6.1 i Rregullores Nr. 33/2012 për shtesat në paga dhe kompensime të tjera të nëpunësve civil, nenit 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

**VENDIM**
**Për kompensimin e punës shtesë jashtë orarit të rregullt të punës për muajin Dhjetor 2022**

1. Me këtë vendim **lejohet** kompensimi i punës shtesë jashtë orarit të rregullt të punës për muajin Dhjetor 2022 për zyrtarët e Komunës së Rahovecit, si në vijim:
   1.1. Muharem Morina - 32 orë për pagesë;
   1.2. Blerta Gashi – 32 orë për pagesë;
   1.3. Skender Hamza – 32 orë për pagesë;
   1.4. Mirsad Shala – 32 orë për pagesë;
   1.5. Senad Mullaavda – 32 orë për pagesë;
   1.6. Bjondina Ramaj – 32 orë për pagesë;
   1.7. Astrit Mullabazi – 32 orë për pagesë.

2. Mjetet për pagesën e punëve jashtë orarit të rregullt sigurohen nga kodi Paga dhe Mëditje.

3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

*Arsyetim*

Duke marrë parasysh se zyrtarët e lartpërmendur, për shkak të volumit të madh të punëve dhe punës të cilën duhet të kryejnë edhe jashtë orarit të rregullt të punës janë të obliguar që të punojnë edhe jashtë orarit të rregullt të punës.

Andaj, duke marrë parasysh këtë, zyrtarët e lartëpërmendur kanë të drejtë kompensimi për punën shtesë për orët të cilët kanë punuar jashtë orarit të rregullt të punës sipas legjislacionit të fuqi në Republikën e Kosovës.

Andaj, nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

***Me vendim të njoftohen:***

- ***Drejtoria për Buxhet dhe Financa,***
- ***Zyra e personelit, dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**
**Kryetari i Komunës**

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 18 Nr. i faq/Br.str/No.pg 96
Data/Datum/Date 10 / 1 / 23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të dispozitave të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), dispozitave të nenit 23 lidhur me nenin 56 paragrafi 2 pika 2.3 dhe 2.5 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, nenit 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

**VENDIM**
**Për kompensimin e punës shtesë jashtë orarit të rregullt të punës për muajin Dhjetor 2022**

1. Me këtë vendim **lejohet** kompensimi i punës shtesë jashtë orarit të rregullt të punës për muajin Dhjetor 2022 për zyrtarët e Komunës së Rahovecit, si në vijim:
   **1.1.** Ruzhdi Krasniqi - 32 orë për pagesë;
   **1.2.** Luan Sharku – 32 orë për pagesë;
   **1.3.** Kushtrim Zeka – 32 orë për pagesë;

2. Mjetet për pagesën e punëve jashtë orarit të rregullt sigurohen nga kodi Paga dhe Mëditje.

3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Arsyetim***

Duke marrë parasysh se zyrtarët e lartpërmendur, për shkak të volumit të madh të punëve dhe punës të cilën duhet të kryejnë edhe jashtë orarit të rregullt të punës janë të obliguar që të punojnë edhe jashtë orarit të rregullt të punës.

Andaj, duke marrë parasysh këtë, zyrtarët e lartëpërmendur kanë të drejtë kompensimi për punën shtesë për orët të cilët kanë punuar jashtë orarit të rregullt të punës sipas legjislacionit të fuqi në Republikën e Kosovës.

Andaj, nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

***Me vendim të njoftohen:***

- ***Drejtoria për Buxhet dhe Financa,***
- ***Zyra e personelit, dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**
**Kryetari i Komunës**

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 33 Nr. i faq/Br.str/No.pg 98
Data/Datum/Date 11/1/23

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 8 paragrafi 1 pika 1.3, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

# VENDIM

**Për caktimin e Këshillit Organizues "Flaka e Janarit"**

1. Caktohet Këshilli Organizues i Ditëve Përkujtimore "Flaka e Janarit", në këtë përbërje:
   - **1.1** Afrim Dina, kryesues
   - **1.2** Avni Morina, anëtar
   - **1.3** Dervish Çadraku, anëtar
   - **1.4** Qemajl Karasniqi, anëtar
   - **1.5** Dafina Gashi, anëtare
   - **1.6** Naser Dula, anëtar
   - **1.7** Shedat Ukaj, anëtar
   - **1.8** Muharem Morina, anëtar
   - **1.9** Besmire Bytyqi, anëtare
   - **1.10** Nora Boshnjaku, anëtare
   - **1.11** Feriz Thaqi - përfaqësuesi i OVL të UÇK-së, anëtar

2. Këshilli Organizues "Flaka e Janarit" ka për detyrë të shpërndajë ftesat për grupe dhe individë të rëndësishëm, të ndaj çmime, të caktoj datën, orën dhe vendin ku do të zhvillohen aktivitetet, të ndërmerr të gjitha veprimet organizative për mbarrëvajtjen e Ditëve Përkujtimore.

3. Organizimi dhe ndarja e përgjegjësive për pjesën operative të Ditëve Përkujtimore "Flaka e Janarit" i takon kryesueses të Këshillit Organizues.

4. Obligohet Këshilli Organizues që të hartoj raport të detajuar për Kryetarin e Komunës mbi mbarëvajtjen dhe shpenzimet e organizimit të Ditëve Përkujtimore "Flaka e Janarit".

5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset kryesuesja dhe të gjitë anëtarët e Këshillit Organizues.

6. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

***Me vendim të njoftohen:***

- ***Anëtarët e Këshillit Oganizues, dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 35 Nr. i faq/Br.str/No.pg 98
Data Datum Date 11.1.23

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës *("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 53 paragrafi 1 dhe 3 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031 të datës 25.05.2016 dhe nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 të datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

**V E N D I M**
**Për shfuqizimin e vendimit Nr. 02/1397/22 i datës 5.1.2022**

1. Me këtë vendim **shfuqizohet** vendimi Nr. 02/1397/22 i datës 5.1.2022 për emërimin e përkohshëm të drejtorit të SHMLP "Selajdin Mullaabazi – Mici" në Rahovec.

2. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Arsim dhe IAAP "Selajdin Mullaabazi – Mici" në Rahovec.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***A r s y e t i m***

Pas përfundimit të procedurave të konkurrimit për pozitën Drejtor/eshë në IAAP "Selajdin Mullaabazi – Mici" në Rahovec, në të cilin konkurs znj. Vjollca Vuqitërna nga Rahoveci është shpallur kandidatja me më së shumti pikë të fituar nga ana e Komisionit përgjedhës gjatë intervistimit të kandidatëve, e njëjta ka nënshkruar kontratë të punës për kohë të caktuar me Komunën e Rahovecit për fillimin e punës në pozitën Drejtoreshë në IAAP "Selajdin Mullaabazi – Mici" në Rahovec.

Për këtë arsye, është e domosdoshme shfuqizimi i vendimit Nr. 02/1397/22 i datës 5.1.2022 për emërimin e përkohshëm të drejtorit të SHMLP "Selajdin Mullaabazi – Mici" në Rahovec.

Andaj, nga se u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese pranë Komisionit për shqyrtimin e ankesave për nëpunësit e shërbimit publik në Komunën e Rahovecit, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të tij.

***Vendimi u dërgohet:***
- ***Z. Arian Rama nga Rahoveci,***
- ***Drejtorisë për Arsim,***
- ***Njësisë së Personelit, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 41 Nr. i faq/Br.str/No pg. 99
Data/Datum/Date 11/1/23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008") dhe neneve 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

## VENDIM
### Për caktimin e komisionit për vlerësimin e dëmeve

1. **Caktohet** komisioni për vlerësimin e dëmit të shkaktuar në kulturën e misrit, sipas kërkesës me Nr. Prot. 73/2023 të datës 11.1.2023, në këtë përbërje:

    **1.1.** Ilvi Durguti, kryesues
    **1.2.** Hasan Vuqitërna, anëtar
    **1.3.** Zamir Haxhibeqirir, anëtar

2. Komisioni ka për detyrë që të konstatoj dhe të bëjë vlerësimin e dëmit të shkaktuar në kulturën e misrit, sipas kërkesës me Nr. Prot. 73/2023 të datës 11.1.2023.

3. Obligohet komisioni që këto punë ti kryejë duke u bazuar në legjislacionin aktual në fuqi.

4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.

5. Komisioni do të hartoj raport me shkrim për Kryetarin e Komunës dhe Drejtorinë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***
- ***Anëtarëve të komisionit,***
- ***DBPZHR, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**
**Kryetari i Komunës**

Njesia Nr/Br/No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 45 Nr. i faq/Br.str/No.pg 99
Data/Datum/Date 13/1/23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

**V E N D I M**
**Për caktimin e Këshillit Organizues**

1. Caktohet Këshilli Organizues për mbarëvajtjen e ceremonisë së varrimit të Prof. Dr. Sabahajdin Cena nga Rahoveci, në këtë përbërje:
   - **1.1** Smajl Latifi, kryesues
   - **1.2** Fatmir Iska, anëtar
   - **1.3** Avni Morina, anëtar
   - **1.4** Afrim Dina, anëtar
   - **1.5** Besnik Hoti, anëtar
   - **1.6** Qemajl Krasniqi, anëtar
   - **1.7** Përfaqësuesi i OVL të UÇK-së, anëtar
   - **1.8** Përfaqësuesi i SHIL të UÇK-së, anëtar
   - **1.9** Përfaqësuesi i Shoqatës së të Burgosurve Politik, anëtar

2. Këshilli Organizues sipas pikës 1 të këtij vendimi ka për detyrë mbarrëvajtjen e ceremonisë së varrimit, organizimin e mbledhjes komemorative dhe organizimin e mbledhjeve dhe takimeve të tjera për Prof. Dr. Sabahajdin Cena.

3. Organizimi dhe ndarja e përgjegjësive për pjesën operative të ceremonisë së varrimit i takon kryesueses të Këshillit Organizues.

4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen të gjitë anëtarët e Këshillit Organizues.

5. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

***Me vendim të njoftohen:***
- ***Anëtarët e Këshillit Oganizues, dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

Republika e Kosovës
Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
**Kryetari i Komunës – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 46 Nr. i faqe/Br.str/No.pg 99
Data/Datum/Date 13 / 1 / 23
RAHOVEC/ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, dispozitave të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 20/2016")*, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

# VENDIM

## 16 JANARI 2023 (DITA E HËNË), SHPALLET DITË ZIE NË KOMUNËN E RAHOVECIT

1. Në shenjë nderimi dhe respekti të veçantë për jetën, veprën dhe kontributin e Prof. Dr. Sabahajdin Cena, me rastin e ndarjes së tij nga jeta, 16 janari 2023 (dita e hënë), është **DITË ZIE** në Komunën e Rahovecit.

2. Obligohen të gjitha institucionet e nivelit lokal, që flamujt kombëtar dhe shtetëror t'i ulin në gjysmështizë.

3. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

***Me vendim të njoftohen:***

- ***Institucionet e nivelit lokal,***
- ***Zyra për Informim, dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**